



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA

MS 19 - 42105

MINISTËR SHTETI PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE
QENDRA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA)

Nr. 484 Prot.

Tiranë, më 13/11 /2015

KONTRATË FURNIZIMI

E lidhur sot më datë 13/11 /2015 në Qendrën e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), Tiranë midis palëve:

Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), **me adresë:**Bulevardi “Zhan d’Ark” (ish hoteli i oficerave), Tiranë,si **Autoritet Kontraktor** përfaqësuar nga **Drejtori i Përgjithshëm Z. Albenc Koni dhe**

shoqërise “Infosoft Systems”Shpk me seli, Rruga “Murat Toptani”, Gjergji Center, Tirane, me NIPT J61820021C perfaqesuar nga **Z. Armand Shara, që këtu e në vijim do të quhet “Kontraktuesi”.**

Neni 1

Objekti i kontratës

Objekt i kësaj kontrate është:“**Blerje pajisje TIK për menaxhimin e sporteleve nga ADISA**”, **ndarë në lote , sipas pershkrimit;**

Loti :“Blerje Kamera, NVR, TV Sets dhe acces control system ”;

Loti : “Blerje UPS-s 600va”;

Loti : “Blerje Printer”;

Loti : “Blerje Projektor”;

Neni 2

Baza Ligjore

Kjo kontrate lidhet mbështetur në Ligjin Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe Kodin Civil te Republikës së Shqipërisë.


Neni 3

Vlera e kontratës

Çmimi total i kontrates perfshin kostot dhe tarifat, duke perfshire taksat dhe tarifat doganore te lidhura me dorezimin e mallrave, pagesa per transportin, testimet, ngarkimet, shkarkimet, udhezimet, manualet dhe dokumentat ne gjuhen e specifikuar dhe te nevojshme per perdorim te rregullt te mallrave si dhe te gjitha detyrimet fiskale tatimore te parashikuara ne legjislacionin shqiptar.

Adresa: Bulevardi “Zhan d’Ark”, ish Hoteli i Oficerave, kati i 6-të Tiranë, Albania

E-mail: informacion@adisa.gov.al


Loti : “Blerje Kamera, NVR, TV Sets dhe acces control system ” me vlere 434,955 (Katërqind e tridhjetë e katër mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë) Lekë pa TVSH ose 521,946 (pesëqind e njëzet e një mijë e nëntëqind e dyzetë e gjashtë) Lekë me TVSH

Loti : “Blerje UPS-s 600va”, me vlerë 85,900 (tetëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind) Lekë pa Tvsh ose 103,080 (njëqind e tre mijë e tetëdhjetë) Lekë me TVSH.

Loti : “Blerje Printer”, me vlerë 21,565 (njëzetë e një mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë) Lek pa TVSH ose 25,878 (njëzet e pesë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë) Lekë me TVSH.

Loti : “Blerje Projektor” me vlerë 102.620 (njëqind e dy mijë e gjashtëqind e njëzet) Lekë pa TVSH ose 123,144 (njëqind e njëzet e tre mijë e njëqind e dyzetë e katër) Lekë me TVSH.

Vlera totale e kësaj kontrate është: 645,040 (gjashtëqind e dyzetë e pesë mijë e dyzetë) lekë pa T.V.SH ose 774,048 (shtatëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e dyzetë e tetë) Lekë me TVSH.

Neni 4

Testimet dhe inspektimet

Kontraktuesi duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga Kontraktuesi brenda kushteve të çmimit të kontratës.

Me shpenzimet e tij, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë Kontraktuesit të bëjë teste ose inspektime shtesë të paraparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Mallrat janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Më tej, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së Kontraktuesit, Autoriteti Kontraktor do të bie dakort të ndryshojë grafikun e levrimit.

Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Mall që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

As ekzekutimi i testeve as inspektimi i Mallrave nuk do ta clirojë Kontraktuesin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

Neni 5

Specifikimet teknike

Mallrat të cilat do të furnizohen nga shitësi do të kenë specifikimet teknike sipas ofertës teknike të paraqitur në tender, Formularit të deklaratës mbi origjinën e mallit dhe deklaratës mbi përmbushjen e specifikimeve teknike. Ato do të shoqerohen nga certifikata e origjinës së mallit dhe certifikata e çilësise.

Neni 6


Afati i Lëvrimit dhe Marrja në dorezim


E gjithë sasia e mallit duhet të lëvrohet, në Tiranë, në magazinën e Autoritetit Kontraktor ku do të kryhet shërbimi i magazinimit, kolaudimit dhe shpërndarjes së mallrave nga vet Autoriteti.

Afati i levrimit do të jetë 35 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Adresa: Bulevardi “Zhan d ‘Ark ”, ish Hoteli i Oficerave , kati i 6-të Tiranë, Albania

E-mail: informacion@adisa.gov.al





Malli do të shoqerohet me fature ku do nënshkruhet dhe procesverbali i kolaudimit në lidhje me sasine dhe specifikimet teknike. Gjithashtu malli do të shoqerohet dhe me manualet si dhe certifikatet e cilësisë dhe certifikatën e origjinës.

Dorezimi i mallit do të kryhet nga person i autorizuar i Kontraktuesit, me dorezime të pjesshme ose për totalin e kontratës të shoqerura nga fatura perkatese.

Neni 7

Mënyra dhe afatet e Pagesës

Pagesa e mallrave do të paguhet nga autoriteti kontraktor brenda 30 ditëve nga data e cdo furnizimi të mallit dhe leshimit të fatures perkatese.

Pagesa do të bëhet në lekë shqiptare dhe urdhër xhirimi në llogarinë e shitësit në: Bankën _____, me Nr. llogarie _____.

Neni 8

Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë t'i likujdohen detyrimet për vonesën në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në dorezimin e mallrave brenda periudhës së zbatimit të specifikuar në kontratë.

Autoriteti Kontraktor mund të zbrese shumën e detyrimeve që duhet paguar nga shumën e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë AK duhet t'i japë Kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsytën e zbritjes.

Autoriteti Kontraktor do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e forcës madhore.

Autoriteti Kontraktor mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethanë të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, ai duhet të njoftojë me përpikëmeri Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorezimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse ky i fundit është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës së nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

Neni 9

Forca Madhore

Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës, detyrimet të likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.

Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtërngime të karantinës dhe embargo tranziti.

Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktor. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të

Adresa: Bulevardi "Zhan d'Ark", ish Hoteli i Oficerave, kati i 6-të Tiranë, Albania

E-mail: informacion@adisa.gov.al



arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 10

Likujdimi i Demeve per Dorezimin e Vonuar

Kontraktuesi, kur nuk realizon këtë kontratë brënda afatit të përcaktuar në të, tarifa ditore për dorëzimin e vonuar do të jetë **4/1000** të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

Neni 11

Vonesa në Bërjen e Pagesës

Shpërblimi për dëmet e shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë konsiston në kamatën e arritur nga data e fillimit të vonesës së debitorit (Autoriteti Kontraktor), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës totale, mbi të cilën është bere llogaritja e tyre.

Neni 12

Negociatat dhe Amendamentet

Palet nuk do negociojne ndryshime ose amendamente te asnje elementi te kontrates qe do te ndryshoje mjaftueshem kushtet qe perbejne bazen e perzgjedhjes se Kontraktuesit. Asnje amendament tjetër i kontrates nuk do te jete i vlefshem pa qene me shkrim, ti referohet shprehimisht te kontrates dhe nenshkruhet nga perfaqesuesit e autorizuar te te dy paleve. Çdo heqje dore nga te drejtat, pushtetet ose ndreqjet qe mund te behen nga palet sipas kontrates duhet te behen me shkrim, te kete date dhe te firmoset nga nje perfaqesues i autorizuar i pales qe ben kete doreheqje dhe duhet te specifikojte te drejten dhe masen ne te cilen ajo leshohet.

Neni 13

Ndërprerja për Mosplotësim

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

- a) Kontraktuesi dështon në dorëzimin e Mallrave brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë sipas parashikimit të nenit 8; ose,
- b) Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

Neni 14

Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paafte të paguajë. Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

Adresa: Bulevardi "Zhan d 'Ark", ish Hoteli i Oficerave, kati i 6-të Tiranë, Albania

E-mail: informacion@adisa.gov.al



Neni 15

Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik. Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit lajmërim me shkrim për ndërprerjen. Autoriteti kontraktor duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Mallrat e pranuar dhe Shërbimet në Lidhje me to, të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Mallrave dhe Shërbimeve në Lidhje me to. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesit do t'i kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

Neni 16

Kohëzgjatja e kontratës

Kohëzgjatja e kësaj kontrate është: Nga data e nënshkrimit të saj nga palët deri me datën e marrjes në dorezim të mallrave dhe likuidimit të vlerës së kontratës, por jo më shumë se 65 ditë.

Neni 17

Sigurimi i kontratës

Kontraktuesi duhet t'i japi Autoritetit Kontraktor garancinë e sigurimit të kontratës në vlerën **77,404.8** (shtatedhjetë e shtatë mijë e katërqind e katër pikë tetë) lekë, brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit për fitimin e kontratës.

Shuma e sigurimit të kontratës duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të realizuar nga deshtimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës. Garancia e sigurimit të kontratës do të kthehet Kontraktuesit pas përfundimit të kohezgjatjes së kontratës.

Neni 18

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshje me negociata direkte. Pjesë integrale e kësaj kontrate është dhe dokumentacioni i mëposhtëm i prokurimit të kësaj procedure:

- Formulari i Kontrates
- Formulari i Deklarimit të Ofertës, të paraqitur nga Ofertuesi
- Përshkrimin e Kërkesës për Kualifikim
- Specifikimet Teknike të paraqitur nga Ofertuesi
- Specifikimet Teknike
- Formulari i çmimit të ofertës
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
- Kushtet e Veçanta të Kontratës
- Njoftimin e Fituesit nga Autoriteti Kontraktor
- Formularin e Sigurimit të Kontratës

Te gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga aplikimi i kësaj Kontrate dhe që nuk mund të zgjidhen me mirekuptim, në bazë të ligjit palet mund të drejtohen Gjykatës Administrative Tiranë për zgjidhjen e tyre.

Adresa: Bulevardi "Zhan d'Ark", ish Hoteli i Oficerave, kati i 6-të Tiranë, Albania

E-mail: informacion@adisa.gov.al

SEKRETARIA
ADISA

Neni 19

Hyrja ne fuqi e kontratës

Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët. Ngarkohet Drejtoria e Sherbimeve Mbeshtetese si dhe Sektori i Furnizimeve prane kesaj Drejtorie, si person përgjegjës për ndjekjen e kësaj kontrate, dhe raporton te Titullari i Autoritetit Kontraktor për realizimin e kontratës deri në përfundimin e saj. Palet pasi e lexuan dhe e gjeten ate konform ligjit dhe interesave te tyre e nenshkruajne ate me vullnetin e tyre te plote.

Kjo kontratë hartohet në 5 (pesë) kopje, të cilat firmosen nga palët në çdo faqe. Një kopje i jepet kontraktuesit.

KONTRAKTUESI

“Infosoft Systems” SH.P.K.

ADMINISTRATORI I PERGJITHEM

Armand SHARA



AUTORITETI KONTRAKTOR

ADISA

DREJTORI I PERGJITHSHEM

Albenc KONI



Adresa: Bulevardi “Zhan d ‘Ark ”, ish Hoteli i Oficerave , kati i 6-të Tiranë, Albania

E-mail: informacion@adisa.gov.al

Albert Shani

FORMULARI I KONTRATËS

Titulli i Kontratës: Objekt i kësaj kontrate është: **“Blerje pajisje TIK për menaxhimin e sporteleve nga ADISA”, ndarë në lote gjithsej 9 lote.**

Lotet përkates objekt i kësaj kontrate është:

Loti : “Blerje Kamera, NVR, TV Sets dhe acces control system ”;

Loti : “Blerje UPS-s 600va”;

Loti : “Blerje Printer”;

Loti : “Blerje Projektor”;

Nr. i Referencës së Kontratës: 24 datë 06/08/2015

Kjo Kontratë është lidhur më 13. 11.2015, midis Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), me adresë: Bulevardi “Zhan d’Ark” (ish hoteli i oficerave), Tiranë, si **Autoritet Kontraktor** përfaqësuar nga **Drejtori i Përgjithshëm Z. Albenc Koni dhe**

shoqëri “Infosoft Systems” Shpk me seli, Rruga “Murat Toptani”, Gjergji Center, Tirane, me NIPT J61820021C përfaqësuar nga **Z. Armand Shara, që këtu e në vijim do të quhet “Kontraktuesi”.**

Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor paraqet një kërkesë për furnizimin e mallrave, duke i’u referuar Prokurimit: **“Blerje pajisje TIK për menaxhimin e sporteleve nga ADISA”, ndarë në lote gjithsej 9 lote.**

Loti : “Blerje UPS-s 600va”, me vlerë 85,900 (tetëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind) Lekë pa Tvsh ose 103,080 (njëqind e tre mijë e tetëdhjetë) Lekë me TVSH.

Loti : “Blerje Printer”, me vlerë 21,565 (njëzet e një mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë)

Lek pa TVSH ose 25,878 (njëzet e pesë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë) Lekë me TVSH.

Loti : “Blerje Projektor”, me vlerë 102.620 (njëqind e dy mijë e gjashtëqind e njëzet) Lekë pa TVSH ose 123,144 (njëqind e njëzet e tre mijë e njëqind e dyzetë e katër) Lekë me TVSH.

Vlera totale e kësaj kontrate është: 645,040 (gjashtëqind e dyzetë e pesë mijë e dyzetë) lekë pa T.V.SH ose 774,048 (shtatëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e dyzetë e tetë) Lekë me TVSH.

Menjëherë pasi Kontraktori, me anë të ofertës së tij, me datë 07.09.2015 bie dakord të furnizoje mallrat, ashtu siç janë të specifikuar në kushtet e përcaktuara në:

- Formulari i Kontrates
- Formulari i Deklarimit të Ofertës, të paraqitur nga Ofertuesi
- Përshkrimin e Kërkesës për Kualifikim
- Specifikimet Teknike të paraqitur nga Ofertuesi
- Specifikimet Teknike
- Formulari i çmimit të ofertës
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
- Kushtet e Veçanta të Kontratës
- Njoftimin e Fituesit nga Autoriteti Kontraktor
- Formularin e Sigurimit të Kontratës

Adresa: Bulevardi “Zhan d’Ark”, ish Hoteli i Oficerave, kati i 6-të Tiranë, Albania

E-mail: informacion@adisa.gov.al

Të gjitha këto dokumenta të bashkangjitur përbëjnë pjesë integrale të kësaj Kontrate. Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor pranon Ofertat nga Kontraktori, në një shumë prej Vlere:

Loti : “Blerje UPS-s 600va”, me vlerë 85,900 (tetëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind) Lekë pa Tvsh ose 103,080 (njëqind e tre mijë e tetëdhjetë) Lekë me TVSH.

Loti : “Blerje Printer”, me vlerë 21,565 (njëzetë e një mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë) Lek pa TVSH ose 25,878 (njëzet e pesë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë) Lekë me TVSH.

Loti : “Blerje Projektor”, me vlerë 102.620 (njëqind e dy mijë e gjashtëqind e njëzet) Lekë pa TVSH ose 123,144 (njëqind e njëzet e tre mijë e njëqind e dyzetë e katër) Lekë me TVSH.

Vlera totale e kësaj kontrate është: 645,040 (gjashtëqind e dyzetë e pesë mijë e dyzetë) lekë pa T.V.SH ose 774,048 (shtatëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e dyzetë e tetë) Lekë me TVSH.

Palët bien dakort si më poshtë:

Kontraktuesi duhet të paraqesë një Sigurim Kontrate në shumën prej: **77,404.8** (shtatëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e katër pikë tetë) lekë, në ose përpara datës së shprehur në Njoftimin e Fituesit.

1. Kontraktuesi është i detyruar të furnizojë për Autoritetin Kontraktor, siç kërkohet në këtë Kontratë.
2. Autoriteti Kontraktor është i detyruar të paguajë për mallrat e levruara, në shumën e parashikuar në këtë Kontratë.
3. Në këtë Formular Kontrate, fjalët dhe shprehjet do të kenë të njëjtin kuptim që i ngarkohet atyre në Kushtet e Kontratës.
4. Palët e kësaj Kontrate kanë përgjegjësi për moszbatim ose zbatim të papërshtatshëm të detyrimeve të tyre kontraktore dhe për dëmet e shkaktuara secilës nga moszbatimi i detyrimeve, që janë subjekt kompensimi, në përputhje me Kushtet e Kontratës.

Sot, më datë 13/11 /2015 palët bien dakort për nënshkrimin e këtij Formulari Kontrate.

KONTRAKTUESI

AUTORITETI KONTRAKTOR

“Infosoft Systems” SH.P.K.

ADISA

ADMINISTRATORI I PERGJITHSHEM

DREJTORI I PERGJITHSHEM

Armand SHARA

Albenc KONI



Adresa: Bulevardi “Zhan d’Ark”, ish Hoteli i Oficerave, kati i 6-të Tiranë, Albania

E-mail: informacion@adisa.gov.al

Albent Shari



FORMULARI I OFERTËS

Emri i Ofertuesit: **Infosoft Systems shpk**

Dt.07.09.2015

Për: Qendra e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)
Bulevardi "Zhan d'Ark" (ish hoteli i oficerave), Tiranë

* * *

Procedura e prokurimit: **E Hapur**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **"Blerje pajisjesh TIK për menaxhimin e sporteve nga ADISA." Loti II "Blerje UPS"**

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike **10.08.2015 Nr.31**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:


1. Çmimi total i ofertës sonë është **85,900** [tetedhjetë e pesë mijë e nentëqind]; leke pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është **103,080** [njetëqind e tre mijë e tetëdhjetë]; leke me TVSH

Nr	Përshkrimi i mallrave	Sasia	Cmimi /Njësi (Leke pa tvsh)	Cmimi total (Leke pa tvsh)	Afati
1.	UPS-s 600 VA- Power Tree S650E	20	4,295	85,900	35 ditë nga momenti i lidhjes së kontratës.
Vlera TOTALE (leke pa TVSH)					85,900
TVSH					17,180
Vlera TOTALE (leke me TVSH)					103,080

Nenshkrimi i ofertuesit

Arsen Kurti

Drejtor i Shitjeve



NUIS: J61820021C

InfoSoft Systems sh.p.k

Rr. Murat Toptani, Gjergji Center, Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 2251 180/1; Fax: +355 4 2232 990

E-mail: infosoft@infosoftgroup.com.al

Web: www.infosoftsystems.al

Kapitali i regjistruar dhe i paguar: 67,400,000.00 Lekë



SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR LOTIN II "Blerje UPS"

UPS

600VA

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
DALJE "OUTPUT"	
Fuqia "Power":	600 VA
Faktori i fuqisë "Power Factor"	≥0.8
Forma e valës "Wave Form"	Sinusoidale
Tensioni nominal "Nominal Voltage":	220-240 VAC
Frekuenca "Frequency":	50 Hz +/- 5%
Rregullimi i Tensionit "Volt, regul. (On battery)":	+/-10%
Prizat dalëse "Output Connectors":	≥ (2) IEC 320 C13 (nga bateria)
HYRIE "INPUT"	
Tensioni nominal "Nominal Voltage":	220-240 VAC
Frekuenca:	50 Hz
Dritarja e tensionit "Voltage window":	170 – 270 VAC
Rregullim automatik i Tensionit "AVR":	Po
Prizat hyrëse "Input Connectors"	(1) IEC 320 C14
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Programi i fikjes "Shutdown Software":	Po
Sinjalizim me dritë "Led indicators":	Për të gjitha gjendjet
Sinjalizim me zë "Audible indicators":	Për të gjitha gjendjet
Prizë për komunikimin e të dhënave "Data":	(1) DB9 Serial ose USB
Mbrojtja "Protection":	Overload, Discharge, and Overcharge Protection
BATERITË	
Koha e transferimit "Transfer time":	≤4 ms
Koha e funksionimit me bateri "Back-Up time":	≥3 min. me ngarkesë të plotë
Tipi i baterive "Battery Type":	12 V DC 7 Ah Lead-acid
AKSESORËT	
Kabëll për linjën kryesore "Power Cord":	(1) European IEC-C13
Kabëll për lidhjen e PC "PC Power Cord":	(2) IEC 320 C13 - IEC 320 C14
Kabëll për komunikimin data "Data cable":	(1) DB9 Serial - DB9 Serial ose USB-USB
GARANCIA	
Periudha e mbulimit të garancisë "Warranty":	2 vjet

FORMULARI I OFERTËS

Emri i Ofertuesit: **Infosoft Systems shpk**

Dt.07.09.2015

Për: Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)
Bulevardi "Zhan d'Ark" (ish hoteli i oficerave), Tiranë

* * *

Procedura e prokurimit: **E Hapur**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: : **"Blerje pajisjesh TIK për menaxhimin e sporteleve nga ADISA." Loti IV "Blerje Printer"**

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike **10.08.2015 Nr.31**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është **21,565** [njetete e nje mije e peseqind e gjashtedhjetë e pese]; leke pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është **25,878** [njetete e pese mije e teteqind e shtatedhjetë e tete]; leke me TVSH


Nr	Përshkrimi i mallrave	Sasia	Cmimi /Njësi (Leke pa tvsh)	Cmimi total (Leke pa tvsh)	Afati
1.	Printer B&w Standard-Lexmark MS312dn	1	21,565	21,565	35 ditë nga momenti i lidhjes së kontratës.
Vlera TOTALE (leke pa TVSH)					21,565
TVSH					4,313
Vlera TOTALE (leke me TVSH)					25,878

Nenshkrimi i ofertuesit

Arsen Kurti

Drejtor Përkrahjeve

Vllas



NUIS: J61820021C

InfoSoft Systems sh.p.k

Rr. Murat Toptani, Gjergji Center, Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 2251 180/1; Fax: +355 4 2232 990

E-mail: infosoft@infosoftgroup.com.al

Web: www.infosoftsystems.al

Kapitali i regjistruar dhe i paguar: 67,400,000.00 Lekë



SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR LOTIN IV "Blerje Printer"

PRINTER

Printer B&W Standard

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Shpejtësia e printimit "Print Speed"	≥30 ppm
Mirëmbajtja mujore "Monthly duty cycle":	20 000 Faqe
Teknologjia "Technology":	Laser B&W
Razolucioni i printimit minimal "Print Quality":	1200x600 dpi
Kapaciteti në hyrje "Input Capacity"	250 Fletë
Pesha specifike e letrës "Media sizes":	60-120g/m ²
Formati i letrës "Media format":	A4/A5/ Envelope
Aftësia e printimit Duplex	Po
Memorja "Memory":	≥128 MB
"Toner":	Shoqëruar me Starter Kit
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Porta e komunikimit "Interface"	High Speed USB 2.0
Portë komunikimi "Ethernet"	Po
AKSESORËT	
Kabëll "Power Cord"	European
Software/Drivers CD	Po
Kabëll USB	Po
GARANCIA	
Periudha e mbulimit të garancisë "Warranty":	2 vjet

FORMULARI I OFERTËS

Emri i Ofertuesit: **Infosoft Systems shpk**

Dt.07.09.2015

Për: Qendra e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)
Bulevardi "Zhan d'Ark" (ish hoteli i oficerave), Tiranë

* * *

Procedura e prokurimit: **E Hapur**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: : **"Blerje pajisjesh TIK për menaxhimin e sporteve nga ADISA."** Loti VI **"Blerje Projektore "**

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike **10.08.2015 Nr.31**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është **102,620** [njqind e dy mije e gjashtëqind e njetete]; leke pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është **123,144** [njqind e njetete e tre mije e njqind e dyzete e kater.]; leke me TVSH


Nr	Përshkrimi i mallrave	Sasia	Cmimi /Njësi (Leke pa tvsh)	Cmimi total (Leke pa tvsh)	Afati
1.	Projektor Tipi 2- Acer P5515	1	102,620	102,620	35 ditë nga momenti i lidhjes së kontratës.
Vlera TOTALE (leke pa TVSH)				102,620	
TVSH				20,524	
Vlera TOTALE (leke me TVSH)				123,144	

Nenshkrimi i ofertuesit

Arsen Kurti

Drejtor i Shitjeve

INFOSOFT SYSTEMS
SH.P.K
OFERTAT



NUIS: J61820021C

InfoSoft Systems sh.p.k

Rr. Murat Toptani, Gjergji Center, Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 2251 180/1; Fax: +355 4 2232 990

E-mail: infosoft@infosoftgroup.com.al

Web: www.infosoftsystems.al

Kapitali i regjistruar dhe i paguar: 67,400,000.00 Lekë



SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR LOTIN VI "Blerje Projektor"

PROJEKTOR

Tip 2

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Tipi "Type"	FULL HD
"Ansi Lumen"	4000
Rezolucioni "Resolution"	1920 x 1080
Sinjalet hyrëse "Input Signal"	NTSC/PAL
Jetëgjatësia e llampës	4000 orë
Raporti i kontrastit "Contrast Ratio":	3000:1
Rregullimi i lenteve "Lens Adjusting":	F Number, Zoom Manual, Focus Manual/Automatik
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat hyrëse "Input Terminal"	HDMI/ VGA /COMPONENT/COMPOSIT/S-Video
AKSESORËT	
Kabëll "Power Cord"	European
Telekomandë "Remote Control"	Po
Kabëll Video	(1) HDMI – HDMI
Kabëll Video	(1) VGA – VGA
Kabëll Video	(1) RCA –RCA
Kabëll Video	(1) S-Video – S-Video
Kapaku i lenteve "Lens Cap"	Po
Software CD	Po
Canta "Carrying Bag"	Po
GARANCIA	
Periudha e mbulimit të garancisë "Warranty":	2 vjet

FORMULARI I OFERTËS

Emri i Ofertuesit: **Infosoft Systems shpk**

Dt.07.09.2015

Për: Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)
Bulevardi "Zhan d'Ark" (ish hoteli i oficerave), Tiranë

* * *

Procedura e prokurimit: **E Hapur**

Përshkrim i shkurtër i kontratës:: **"Blerje pajisje TIK për menaxhimin e sporteve nga ADISA" Loti VIII: "Blerje Kamera, NVR, TV Sets dhe acces control system"**


Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike **10.08.2015 Nr.31**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është **434,955** [katerqind e tridhjetë e kater mije e nentëqind e pesdhjetë e pese]; leke pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është **521,946** [peseqind e njetete e nje mije e nentëqind e dyzete e gjashtë]; leke me TVSH

Nr	Përshkrimi i mallrave	Sasia	Cmimi /Njësi (Leke pa tvsh)	Cmimi total (Leke pa tvsh)	Afati
1.	NVR Hikivision NVR DS-7604NI-E1 9	1	80,572	80,572	35 ditë nga momenti i lidhjes së kontratës.
2.	Camera IP Hikivision DS-2CD2112F-I	2	40,286	80,572	35 ditë nga momenti i lidhjes së kontratës.
3.	Tv Sets (public info and camera systems) Fuego 32 FG3300 TV	2	36,191	72,382	35 ditë nga momenti i lidhjes së kontratës.
4.	Alarm & Access control system Sistemi I aksesit CDVI CTV-900 (+2 reader) + AVS Electronics Xstream6	1	201,429	201,429	35 ditë nga momenti i lidhjes së kontratës.
Vlera TOTALE (leke pa TVSH)				434,955	
TVSH				86,991	
Vlera TOTALE (leke me TVSH)				521,946	


Nënshkrimi i ofertuesit
Arson Kurti
Drejtor i Përgjithshëm
Vula



NUIS: J61820021C



InfoSoft Systems sh.p.k

Rr. Murat Toptani, Gjergji Center, Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 2251 180/1; Fax: +355 4 2232 990

E-mail: infosoft@infosoftgroup.com.al

Web: www.infosoftsystems.al

Kapitali i regjistruar dhe i paguar: 67,400,000.00 Lekë

SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR LOTIN VIII "Blerje Kamera, NVR dhe TV Sets"

SEKRETI

Kamera

Karakteristikat e KAMERAVE	Vlerat specifike
Tipet dhe Nentipet e Kamerave	Indoor, Dome
Procesori i Figures	1/3 CMOS sensor
Rezolucioni i Figures	720p
Ndeshmëriaminimalendajdritës e maturnë 50 IRE: Color (me Ngjyra) B/W (Bardhe e Zi)	Maturnë 30 IRE;
"Shutter Speed"	1/25 to 1/10,000s
Reduktimiizhurmës ("Noise Reduction")	2D
Tipi ilenteve	Fikse
Largësiafokale ("Lens type")	2.8 mm + 15%
Raportioptikizmadhimit ("Optical Zoom Ratio")	N/A
Ndriçimi Infra tëKuqe ("IR illuminators")	Deri ne 15 m
Rezistencandajvandalëve	IK10
Ditë/Natë	"True Day/Night: automatic IR cut filter
Stabilizues figure ("Image Stabilizer")	Po
Diapazonidinamikindjeshmërisë, minimumi (Minimum Dynamic range)	95 dB
Karakteristikatpër PTZ pan/tilt (Vetëmpërkamera PTZ)	N/A
Formatiikompresimittë Videos	H.264
Vleramaksimale e kuadritpërsekond "Maximum frame rate" (nërezolucioninmaksimal)	30 fps
Dedektim i lëvizjes ("Motion Detection")	Po
Dedektiminteligjentilëvizjes("Intelligent Motion Detection")	Po. Min.10 m.
Alarm përrastsabotimitëkamas ("Tampering Alarm")	Po
Alarmetëtjertatëcilataktivizohen duke analizuarfigurën.	Jo
Audio	Jo
Pajtueshmëria e sistemit	ONVIF
Temperatura e funksionimit	-10 °C to +50 °C
Ushqimi	24 VAC, 12 VDC, PoE (802.3af)

NVR

4-Channel NVR	
Inputs	4 channel
Video Outputs	HDMI , VGA
Display Resolution	1920×1080, 1280×1024, 1280×720, 1024×768
Display Frame Rate	30 fps per channel

Dokumentat Standarde të Tenderit

Compression Format	H.264
Recording Mode	up to 1920 x 1080
Recording Frame Rate	Real Time: NTSC/PAL
Recording Modes	Motion Detection, Continuous
Multiplex Operation	view/playback/record
HDD/SSD	Min 1TB installed expandable
PTZ	Support PTZ cameras
Network Interface	1 RJ-45 10 /100 /1000 Mbps self-adaptive Ethernet interface/ independent 100 Mbps PoE network interfaces 4
Alarm	Buzzer, Display on Screen Record, Snapshot, E-Mail, HTTP, etc
Notification	SMTP, HTTP, E-Mail, etc
Network Protocol	1 RJ-45 10 /100 /1000 Mbps self-adaptive Ethernet interface. TCP/IP, PPPoE, DHCP, DNS, DDNS, NTP, SMTP, SNMP, UPnP,
DNS support	Yes
General	
Power Supply	Ac ,100-240 V 50/60 Hz
USB Interface	Min.2 USB 2.0 Interfaces
Software	Included

*Shenim: NVR dhe kamera eshte mire te jene te te njejtit brand. Kjo gje lehteson instalimin dhe mirembajtjen.

TV

Tipi	LCD/LED IPS
Madhesia	32"
Kontrast	Mega Contrast
Nderfaqe	Min. VGA, HDMI, usb
Speakers	Po
Ushqimi	220V, 50/60 Hz, european
Garancia	3 vjet
Te tjera	Suport per montim ne mur.

Kompania ofertuese duhet te realizoj dhe montimin e TV sipas kerkeses.

Alarm dhe Akses Control System

Sistemi duhet të regjistrojë hyrjet dhe daljet nëpërmjet skanimit të kartës (badge).